

Veçoritë strukturale të ekonomisë së Kosovës

Fetah Reçica*

Përmbledhje

Ballë e kërkimit shkencëror në zhvillimin ekonomik të vendit të

[Metadata, citation and similar pa](#)

repository

produktet dhe shërbimet e realizuara. Zhvillimi i industrisë dhe resurset natyrore janë të një rëndësie të veçantë në këtë drejtim. Industria i kontribuon më së shumti zhvillimit ekonomik dhe ndarjes së punës. Ajo krijon mundësi për rindërtimin dhe avancimin e degëve të tjera ekonomike si bujqësisë, komunikacionit, tregtisë e të tjera. Ndikimi i industrisë në transformimin e strukturës ekonomike dhe sociale të vendit është i lartë ose i dobët, varësisht nga niveli i zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të vendit.

Ekonomia e Kosovës pas luftës është ballafaquar me sfida të mëdha, si pasojë e menaxhimit të dobët për një dekadë të tërë dhe e luftës shkatërrimtare. Megjithëkëtë, Kosova me sukses e kaloi fazën e rindërtimit, e cila ishte mjaft e vështirë. Fillimi i privatizimit, zhvillimi dinamik i sektorit privat në ndërmarrje të vogla dhe të mesme, me theks të veçantë sektori i prodhimit, nismat e para të procesit të integrit me ekonominë e rajonit përmes nënshkrimit të marrëveshjes për tregti të lirë, inkuadrimi në Paktin e Stabilitetit si anëtare jo e barabartë, janë vetëm hapat e parë të proceseve të gjata dhe të rënda drejt zhvillimit të ekonomisë së tregut dhe integritimeve në institucionet rajonale dhe ndërkombëtare. Në periudhën e pasluftës, ekonomia e Kosovës ishte ekonomi konsumuese dhe nevojat e veta kryesisht i plotësonte nga importi, duke e përdorur "keshin" si mjet pagese në mungesë të institucioneve të organizuara financiare.

Struktura ekonomike e një vendi, për zhvillimin ekonomik, më tepër se cilido tregues tjetër paraqet kahet dhe realitetin

* Prof. ass. dr. Fetah Reçica, Universiteti AAB-Rinvest, Universiteti i Prishtinës, Republika e Kosovës, fetah.regica@universitetiaab.com

zhvillimor. Pra, ajo trajtohet si gjenerator aktual në çdo kohë dhe në çdo shoqëri bashkëkohore.

Fjalët kyç: Ekonomia e Kosovës, zhvillimi ekonomik, resurset natyrore dhe ato humane, investimet, privatizimi, shënimet statistikore.

1. Karakteristikat kryesore të zhvillimit të deritanishëm ekonomik të Kosovës

Kosova me sipërfaqe prej 10.887 km² paraqet një tërësi gjeografike e cila shtrihet në gjerësi gjeografike 43°10', dhe 41°47' dhe gjatësi gjeografike 20°53' dhe 20°34'. Kosova kufizohet në pjesën jugore me Maqedoninë, në pjesën jugperëndimore me Shqipërinë, në veriperëndim me Malin e Zi si dhe me Serbinë në verilindje dhe në juglindje.¹ Ajo gjendet në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik dhe nga të gjitha anët, me përjashtim të lindjes, është e rrethuar me male të larta. Pozita gjeografike, strategjike dhe konfiguracioni geomorfologjik mundësojnë që Kosova të paraqesë një kryesore për gërshetimin e rrjetit të infrastrukturës së komunikacionit në këtë pjesë të Evropës.

Zhvillimin ekonomik të Kosovës në mes dy luftërave botërore e karakterizon depërtimi i ngadalshëm i elementeve të prodhimit kapitalist dhe ruajtja e gjatë e mënyrës së prodhimit feudal, e cila bëri që për një periudhë të gjatë kohore të mos ndërrojnë asgjë në mënyrën e jetesës dhe standardit të popullsisë në Kosovë. Zhvillimi ekonomik, para se gjithash, duhet të shqyrtohet si një ndërlidhje e përgjithshme materiale, shoqërore si dhe e kushteve në të cilat është realizuar.² Nuk mund të jetë e drejtë, nëse nuk hulumtohet e kaluara e tyre, dhe nëse një e kaluar si do që të jetë, të mos krahasohet me format e zhvillimit bashkëkohor ekonomik-shoqëror. Një nga pyetjet e shpeshta në vendet e pazhvilluara është zgjidhja e metodave të zhvillimit ekonomik. Më së tepërmi parashtrohet pyetja, a i

¹ Instituti për hulumtime zhvillimore "Riinvest", *Zhvillimi ekonomik lokal*, Prishtinë, 2004, f.69.

² Mr.sc. Fetah Reçica, *Komunikacioni, faktor i zhvillimit ekonomik të Kosovës*, tezë e doktoratës, Prishtinë, 2004 f. 38 (dorëshkrim).

duhet dhënë prioritet kohor më tepër zhvillimit të bujqësisë apo zhvillimit të industrisë? Përgjigja kësaj pyetjeje duhet të jetë e qartë. Në vendet e pazhvilluara kryesisht mbizotëron struktura agrare dhe ndarja e dobët e punës, të cilën në masë të dukshme mund ta ndërrojë dhe ta avancojë zhvillimi më i shpejtë i industrisë dhe i veprimtarive të tjera ekonomike.³

Në Kosovë për një periudhë të gjatë bujqësia ishte veprimtaria kryesore ekonomike, me një strukturë të pavolitshme të kulturave agrare, me pajisje primitive dhe me rendimente tejet të ulëta. Kultivoheshin kryesisht drithërat të cilat ishin të dedikuara për ushqimin e popullsisë dhe bagëtisë. Fondi i bagëtisë ishte tejet i vogël dhe dominonte një racë e cilësisë së dobët. Resurset natyrore të Kosovës ishin të njohura që nga kohët e lashta dhe ato eksploatoheshin nga ilirët, popull vendës, pastaj nga pushtues të tjerë siç ishin: romakët, bizantinët, sasët, turqit e së fundi përsëri sllavët.⁴ Objektet industriale ishin të pakta dhe të pajisura dobët me mjete themelore, të cilat u përngjanin punëtorive zejtare dhe kishin karakter manifaktural. Pjesa më e madhe e prodhimeve industriale ishte e lidhur me metalurgjinë e ngjyrosur. Marrë në tërësi, midis dy luftërave botërore, përveç "Trepçës", nuk është ngritur asnjë objekt me rëndësi të veçantë industriale.⁵ Eksploatimi i xehes dhe i resurseve të tjera natyrore, me gjithë faktin se ishin të shfrytëzuara nga firmat dhe kapitali i jashtëm, bëhej në mënyrë të paorganizuar, të vrazhdë dhe mjaft primitive. Zhvillimi i degëve të tjera ishte i padukshëm apo i një niveli tejet të ulët. Nga aspekti historik, zhvillimi ekonomik i Kosovës ka kaluar nëpër faza të ndryshme.

Në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore (1945), në zhvillimin ekonomik të Kosovës si edhe të çdo vendi tjetër që ka dalë nga lufta, në veçanti, rëndësi e posaçme i është kushtuar zhvillimit të degëve ekonomike të cilat absorbojnë fuqi më të mëdha punëtoresh dhe të cilat krijojnë të ardhura më të larta, si

³ Po aty, fq. 42.

⁴ Dr. S. Berisha, "Ekonomia e Kosovës - dje, sot dhe nesër", në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filologjik, Prishtinë 2003. f. 49.

⁵ Dr. T. Abdyli, *Zhvillimi i industrisë në Kosovë*, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1978, f. 28.

industria e cila ishte e orientuar në shfrytëzimin e resurseve natyrore. Pas Luftës së Dytë Botërore, shumë vende të botës (të zhvilluara dhe në zhvillim), shënojnë zhvillim relativ të forcave prodhuese. Megjithatë, ekziston mendimi se vendet e zhvilluara industriale kanë arritur ritëm të zhvillimit të cilin ka qenë vështirë ta përcjellin edhe vendet në zhvillim, me gjithë faktin se vendet në zhvillim kanë arritur një shkallë relativisht të lartë të zhvillimit. Vendet në zhvillim gjithnjë e më tepër paraqiten si faktor i rëndësishëm në ecuritë e zhvillimit ekonomik botëror. Zakonisht, ato realizojnë shkallë më të lartë të zhvillimit sesa vendet e zhvilluara industriale.⁶ Në këtë kohë, në Kosovë mbretëronte një varfëri e madhe. Por, me kalimin e kohës u paraqit nevoja edhe për degë të tjera ekonomike.

2. Periudhat e zhvillimit të deritashëm

Bazuar në vëllimin dhe në dinamikën e investimeve në periudhën 1945-1960 dallojmë proceset e para kur edhe fillon rindërtimi dhe aftësimi i kapaciteteve ekzistuese të industrisë bazë, që pati për qëllim intensifikimin e shfrytëzimit të resurseve natyrore dhe vënien e bazës për fillimin e procesit të industrializimit të ekonomisë, i cili daton që nga viti 1961. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur investime të cilat vlejné të theksohen. Investimet kryesisht ishin mjetet pa kthim dhe në një sasi tejet të vogël.

Pra, kjo periudhë karakterizohet me një ritëm të ngadalshëm të zhvillimit ekonomik dhe me shfrytëzimin ekstensiv të faktorëve të prodhimit. Ritmet e ngadalshme të zhvillimit ekonomik në këtë periudhë, me gjithë vështirësitë e trashëguara, kanë qenë rezultat i veprimit të shumë faktorëve të tjerë, prej të cilëve si më të rëndësishëm duhet theksuar strategjia globale e industrializimit të vendit dhe ndryshimet sistimore.⁷

⁶ Dr. J. Sirotković, *Teorija i politika ekonomskog razvoja, Drugo dopunjeno izdanje, "Informator"*, Zagreb, 1976, f. 124.

⁷ *Koncepti i zhvillimit afatgjatë të KSA të Kosovës deri në vitin 2000*, "Instituti Ekonomik", Prishtinë, 1985, f. 27.

Vëllimi i investimeve. Me gjithë gjendjen e krijuar as për së afërmi nuk i përgjigjej intensitetit dhe kërkesave për rimëkëmbjen ekonomike, ekzistonte një shpërpjesëtim i madh në mes të investimeve ekonomike dhe joekonomike. Për një ekonomi të tillë të pazhvilluar me investime tejet të vogla, të cilat gjithashtu kishin një strukturë të pavolitshme të shpërndarjes sipas degëve dhe lëmenjve ekonomikë, nuk shihej ndonjë perspektivë afatgjatë dhe e afërt. Shkalla e zhvillimit, edhe pse shënonte rezultate, edhe më tej ishte në nivel mjaft të ulët në krahasim me pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë dhe nga dita në ditë rritej ndryshimi zhvillimor i Kosovës me republikat e tjera të ish-Jugosllavisë. Gjithashtu, pas Luftës së Dytë Botërore, shumë vende të zhvilluara dhe ato në zhvillim, shënojnë rezultate relativisht të larta në zhvillimin ekonomik. Megjithatë, është e vërtetë se edhe pse vendet e zhvilluara kanë arritur shkallë më të ulët të zhvillimit, ndryshimi në mes të vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim është gjithnjë në rritje, gjë që ishte e shprehur në shkallë mjaft të lartë edhe në Kosovë, krahasuar me pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë.

Në këtë periudhë, produkti shoqëror për kokë të banorit ishte 88 dollarë (mesatarja jugosllave 170 dollarë), e ardhura kombëtare 38.000 dinarë (Jugosllavia 73.000 dinarë),⁸ e cila tregon se niveli i të ardhurave kombëtare në Kosovë, krahasuar me mesataren e Jugosllavisë ishte rreth 52% . Një kohë të gjatë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, përqendrimi për një zhvillim më intensiv ishte në regjionet e tjera të ish-Jugosllavisë e cila politikë zgjati deri sa ishte edhe vetë ish-Jugosllavia. Sipas këtyre politikave zhvillimore, Kosova ishte e lënë pas dore, me fjalë të tjera nuk respektohej parimi “zhvillimi i barabartë i viseve të pazhvilluara”.⁹ Në bazë të kësaj, Kosova fiton statusin e prodhuesit të lëndëve të para për viset e tjera më të zhvilluara të Jugosllavisë. Kjo mund të ilustruhet me faktin se vetëm energjetika dhe metalurgjia e ngjyrosur në prodhimin shoqëror të Kosovës merrnin pjesë me afro 50%.¹⁰ Një gjë e tillë më së miri mund të shihet tani pas mbarimit të luftës së vitit 1999 në


⁸ *Po aty*, f. 26.

⁹ Mr.sc. Fetah Reçica, vep. cit., f. 18.

¹⁰ Dr S. Berisha, art.cit., f. 52.

Kosovë, ku kapacitetet e tilla (minierat) po hasin vështirësi për aktivizim të procesit të prodhimit. Së pari, për shkak të dëmeve të shkaktuara nga lufta, për shkak të teknologjive të vjetruara , si dhe të humbjes së tregut të dikurshëm.

Ngecja e këtyre në ritmin e zhvillimit dhe mospërkrahja nga ana e shtetit për zhvillim të barabartë të të gjitha pjesëve të ish-Jugosllavisë ka pasur për pasojë pjesëmarrjen mjaft të ulët të prodhimit kosovar në prodhimin e përgjithshëm jugosllav. Një ndryshim i tillë i zhvillimit të Kosovës në krahasim me vendet e tjera të ish-Jugosllavisë ishte përherë e më i theksuar, dhe shprehej edhe në analizat e ndryshme të ekspertëve vendës. Kjo mund të ilustron edhe nëpërmjet këtyre të dhënave:¹¹



	Koeficienti i zhvillueshmërisë				Rangu i zhvillueshmërisë			
	1953	1971	1981	1989	1953	1971	1981	1989
RSFJ	100,0	100,0	100,0	100,0	-	-	-	-
Slovenia	151,6	144,3	138,8	162,2	1	1	1	1
Serbia	90,8	99,4	100,4	104,5	4	3	3	2
B e H	103,8	85,8	88,0	87,4	2	5	5	4
Mali i Zi	103,0	101,1	107,6	102,3	3	2	2	3
Maqedonia	78,0	92,1	94,0	86,4	5	4	4	5
Kosova	72,6	75,4	71,1	56,9	6	6	6	6

*Ecuritë e investimeve në ekonominë e Kosovës sipas veprimtarive në periudhën 1959-1994*¹²

¹¹ Vjetari statistikor i RSFJ, 1990.

¹² Oda Ekonomike e Kosovës, 2001. Në periudhën e viteve 1990-94, të dhënat janë në 000 dinarë të rinj dhe çmimet e vitit 1994; në milion dinarë - çmimet e vitit 1972.

	Indus. Xeht.	Bujq. Peshk.	Pyllt.	Hidr- Ekon.	Ndërt.	Komu. lidhjet	Tregt.	Hot. Turiz.	Zejt.
1959	367,9	157,6	5,7	-	9,0	52,3	22,5	-	0,7
1969	1.392,2	126,9	4,4	7,0	22,6	273,7	71,4	20,0	3,8
1979	2.265,8	285,5	11,4	314,7	112,3	321,1	101,6	54,3	55,2
1989	380,0	200,0	10,0	10,0	10,0	140,0	60,0	20,0	60,0
1990*	29.284	67.815	4.645	-	7.272	47.906	19.834	2.199	4.413
1991	23.199	46.697	4.021	-	7.272	44.285	19.834	2.199	4.413
1992	10.663	45.636	3.204	-	7.272	21.004	16.232	2.194	3.990
1993	5.519	29.259	1.602	214	5.049	14.233	10.845	1.460	2.593
1994	5.093	27.451	1.600	191	4.349	12.424	9.557	1.254	2.407

Për të analizuar më mirë nivelin e zhvillimit ekonomik të Kosovës, kemi përfshirë disa nga republikat e ish-Jugosllavisë dhe Kosovën. Realiteti i gjithë kësaj qëndron në atë se, pa marrë parasysh numrin dhe llojin e treguesve me të cilët do të prezantonim zhvillimin relativ të republikave dhe të krahinave të ish-Jugosllavisë, Kosova në të gjitha rastet dhe në të gjitha periudhat (vitet) ishte e fundit. Zhvillimi më i ngadalshëm i Kosovës krahasuar me republikat e tjera të ish-Jugosllavisë ishte i pranishëm në çdo periudhë krahasuese.

Periudha 1961-1975 ishte më dinamike në krahasim me periudhën e kaluar dhjetëvjeçare. Zhvillimi ekonomik i Kosovës u realizua në normën vjetore të rritjes 5,7% ,¹³ duke pasur parasysh se baza krahasuese e zhvillimit ishte simbolike. Zhvillimi ekonomik ishte i një karakteri agrar, me probleme të theksuara në sferën sociale dhe të papunësisë.

Megjithatë, ky zhvillim kishte karakter ekstensiv dhe përcillej me probleme dhe konflikte të cilat i kontribuuan rritjes së diferencave zhvillimore ndërmjet Kosovës dhe pjesëve të tjera të ish-Jugosllavisë. Zhvillimi ekonomik i Kosovës në këtë periudhë ishte i bazuar kryesisht në shfrytëzimin më intensiv të resurseve natyrore dhe të fuqisë punëtore (e cila në krahasim me vendet e tjera në regjion ishte e moshës më të re).

Deri në vitet e shtatëdhjeta nuk paraqitet ndonjë rezultat që vlen të veçohet. Ekonomia kishte karakter agrar ekstensiv, me përgatitje tejet të dobët dhe me rendimente të ulëta, që nuk

¹³ Oda Ekonomike e Kosovës, *Ecuritë ekonomike*, Prishtinë, 1987.

arrinte t'i plotësojë as nevojat elementare të popullsisë me prodhimet e saj. Ecuritë ekonomike në vitet e shtatëdhjeta dëshmojnë rezultate të shumta në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik (rritjen e vëllimit fizik të prodhimit, si dhe strukturën e avancuar ekonomike të Kosovës).¹⁴ Kjo ishte edhe si dëshmi se Kosova e pavarur politikisht do të ketë rezultate edhe në pavarësinë ekonomike për ç'gjë ekzistonin parakushtet.

Periodha 1976-1989 me gjithë zhvillimin më të hovshëm ekonomik të Kosovës, shënon rezultate më të larta të zhvillimit si rezultat i autonomisë së barabartë të Kosovës me republikat e tjera të ish-Jugosllavisë. Në këtë periudhë paraqiten shumë vështirësi dhe probleme të pazgjidhura, të cilat kanë pasur ndikim të përhershëm në zhvillimin e mëtejshëm dhe në zgjidhjen e problemit të papunësisë, si një nga çështjet me rëndësi të posaçme, jo vetëm për zhvillimin ekonomik dhe social, por edhe për atë politik.

Në fillim të viteve të tetëdhjeta, si rezultat i paraqitjes së krizës ekonomike dhe politike në ish-Jugosllavi, çështja e Kosovës u ashpërsua si një çështje komplekse, e cila gjithnjë e më shumë i tejkalonte kufijtë e ish-Jugosllavisë. Produkti shoqëror ishte në rënie të përhershme, me gjithë shtimin demografik të popullsisë i cili ishte në rritje. Niveli i zhvillimit ekonomik në Kosovë, në krahasim me mesataren e ish-Jugosllavisë ishte në rënie graduale (në vitin 1947 ishte 49% e mesatares së ish-Jugosllavisë kurse me 1989 kishte rënë në 27%).

Edhe pse në kuptimin absolut është arritur një normë e shtimit në zhvillimin e përgjithshëm, krahasuar me vendet e tjera të ish-Jugosllavisë, ajo është mjaft e ulët.

Periodha 1976-1989 paraqet një zhvillim spontan. Kur flasim për zhvillimin ekonomik të Kosovës duhet të përmendim edhe periudhën e okupimit serb, i cili për ekonominë e Kosovës ishte fatal- ai fillon pas marrjes së autonomisë së Kosovës (28 mars 1989). Kuvendi i Serbisë vendosi masat e dhunshme në 336 ndërmarrje dhe institucione të Kosovës me pretekst të mbrojtjes

¹⁴ Kuvendi i KSA të Kosovës, Enti krahnor për planifikimin shoqëror, *Ecuritë aktuale ekonomike në Kosovë, Prishtinë, 1989, f.19.*

së pasurisë shoqërore, por në fakt me qëllim të plaçkitjes së saj. Veprimet qenë tepër të vrazhda dhe militante, duke mos përfillur ligjshmërinë, madje as atë që e miratonte vetë Kuvendi i Serbisë. Ato manifestoheshin me forma të ndryshme (integrimi me dhunë dhe pa dokumentacion përkatës në ndërmarrjet serbe, shitja e ndërmarrjeve me çmime simbolike, privatizimi i tyre sipas përkatësisë kombëtare, politike, familjare, pastaj bëhej vjedhja e pajimeve, teknologjisë, mallrave, mjeteve financiare e të tjera.

Që nga kjo periudhë, ndërmarrjet kosovare (shoqërore dhe publike) fillojnë të stagnojnë.

Pas përfundimit të luftës, ekonomia e Kosovës rezultoi e shkatërruar dhe me plaçkitje të paparashikuar, si në sektorin shoqëror, ashtu dhe në sektorin privat. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve shoqërore dhe publike, për shkak të dëmeve të shkaktuara nga lufta dhe stagnimit dhjetëvjeçar, hasën në vështirësi për aktivizimin e kapaciteteve të tyre.

Duke iu falënderuar periudhës së tranzicionit, e cila kishte filluar me formimin e ndërmarrjeve private, ekspertët kosovarë filluan të orientojnë idetë dhe kapitalin në ndërmarrjet e këtilla. Kjo formë e pronës prej dite në ditë ishte më e suksesshme. Numri i ndërmarrjeve private të të gjitha degëve dhe lëmenjve ekonomikë rritet gjithnjë e më tepër, gjë e cila shpreh një interes për zhvillimin ekonomik të Kosovës së pavarur.

Si në gjithë vendet në tranzicion, edhe në Kosovë ndërmarrjet shoqërore dhe publike hasën në vështirësi për thithjen e investimeve të reja, dhe aktivizimin e kapaciteteve për shkaqe të shumta (siguria e investimeve, titullari i papërcaktuar i pronësisë në ndërmarrjet shoqërore dhe publike, teknologjia e vjetruar etj.) me gjithë interesin dhe ndihmën e madhe të bashkësisë ndërkombëtare.

Lufta në vitin 1999, e ka lënë Kosovën në një situatë të tmerrshme, ku standardi jetësor sot nuk është më i lartë se gjysma e nivelit që ka ekzistuar në mbarim të viteve të tetëdhjeta. Vetëm një e treta e popullsisë së aftë për punë është e punësuar, sektori i prodhimit është i një niveli jo konkurrues me atë në rajon si dhe ka mungesë të objekteve në infrastrukturën themelore dhe në shërbimet publike.

Rindërtimi i Kosovës në periudhën e pas luftës u zhvillua në dy faza. Në fazën e parë u ndërmorën masat e shpejta për tejkalimin e gjendjes shumë të rëndë të pasluftës, e cila njihet me emrin faza emergjente.

Faza emergjente e rindërtimit zgjati që nga qershori i vitit 1999 e deri në fund të vitit 2000, e cila kishte të bënte me zgjedhjen e problemeve më të rënda për Kosovën, të shkaktuara nga lufta (strehimi i popullsisë, aktivizimi i kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese si dhe infrastrukturës publike, krijimi i një baze të përshtatshme ligjore për zhvillimin ekonomik).¹⁵ Masat qenësore të cilat kishin të bënin me fillimin e ndërtimit të sistemit të ri ekonomik, paraqiten si fazë e dytë e cila njihet si faza substanciale.

Gjatë kësaj periudhe theksohet edhe kontributi i donatorëve të jashtëm dhënë Kosovës, i cili ishte i menaxhuar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim, dhe i cili prezantohet në tabelën e mëposhtme, nga e cila shihet se donatorët e jashtëm nëpërmjet Agjencisë Evropiane për Rindërtim, për ndërtimin e Kosovës dhe shërbimeve vitale, kanë angazhuar afër 854 milionë Euro.¹⁶

Sektorët	1999	2000	2001	2002	Total
Energjetika dhe shërbimet publike	25	136	155	60	376
Rindërtimi i shtëpive	14	60	38	16	128
Administrata civile	41	10	39	17	107
Infrastruktura	14	15	18	6	53
Bujqësia	1	12	27	9	49
Ndërmarrjet	5	15	22	10	52
Shëndetësia	1	10	14	5	30
Shpenzimet organizative	5	4	14	3	26
Të tjera	21	-	3	9	33
Gjithsej	127	262	330	135	854

Kontributi i donatorëve për rindërtimin e Kosovës - në milion Euro

Masat e ndërmarra ishin të orientuara kryesisht në aktivizimin dhe stabilizimin e energjisë elektrike, funksionimin e telekomunikimeve, komunikacionit ajror dhe në themelimin e sistemit financiar.

¹⁵ Raporti vjetor i aktivitetit të donatorëve në Kosovë, janar-dhjetor 2002, shtator 2003.

¹⁶ Dr. S. Berisha, art.cit., f. 61.

Faza substanciale e zhvillimit të pasluftës vazhdon edhe tani me procesin e privatizimit të ndërmarrjeve ekonomike në pronësi shoqërore, ndërtimin dhe rregullimin e rrjetit rrugor, ujësjellësit, kanalizimit, përçuesve të energjisë elektrike, sistemeve të ujitjes, ngrohjes etj. Ndërtimi i këtyre objekteve të cilat njihen si objekte të infrastrukturës komunale, kanë rëndësi për dy arsye. E para, ato ndikojnë pozitivisht në ngritjen e nivelit të standardit jetësor, familjar dhe standardit të përgjithshëm shoqëror, dhe e dyta ato janë parakusht për zhvillimin ekonomik, ku krahas ngritjes së kapaciteteve industriale duhet të investohet edhe në realizimin e projekteve konkrete. Ekonomia do të ndërtohet mbi bazën e konkurrencës së lirë, e cila nënkupton qasjen e barabartë të ndërmarrjeve në treg, pavarësisht nga pronësia, ato nuk do të pengohen nga masat e ndryshme qeveritare sa u përket doganave, tatimeve, kredive, themelimit etj.

3. Problemet të cilat po e përcjellin ekonominë e Kosovës në periudhën e pasluftës

Pas luftës, problemet të cilat e kanë përcjellë ekonominë e Kosovës mund të grupohen në:

- Energjia elektrike jostabile.
- Privatizimi dhe rindërtimi i ngadalshëm.
- Mungesa e investimeve, posaçërisht e investimeve nga jashtë, si rezultat i pasigurisë politike.
- Mungesa e tregut të kapitalit financiar (kamatat e larta me afat të shkurtër kthimi).
- Tregu tepër liberal. Këtu veçohen mallrat nga Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi, të cilat përbëjnë mbi 50% të mallrave të importuara. Kjo vetëm nga shkakun se mallrat që hyjnë në Kosovë nga këto vende nuk i nënshtrohen taksës së rregullt doganore.
- Ngarkesa e lartë e investimeve kapitale dhe repromaterialit të importuar me tatim dhe doganë (që në pikat kufitare), e cila destimulon prodhimin vendor, dhe në të kundërtën stimulon importin nga vendet e cekura më lart.

- Përkrahja e pamjaftueshme e bizneseve fillestare dhe NVM-ve, qoftë përmes stimulimeve dhe konsultimeve të ndryshme profesionale të organizuara në formë të seminareve, qoftë nëpërmes trajnimeve nga ana e shtetit apo institucioneve shtetërore dhe shoqatave të biznesit.¹⁷
- Vështirësitë për qarkullimin e shpejtë dhe efikas të afaristëve jashtë vendit.

Gjatë periudhës së pasluftës, investimet ishin të orientuara kryesisht në tregti (ndërtimi i pikave të karburanteve), në energjetikë, në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrjetit rrugor, ndërtimin e objekteve të rrënuara gjatë luftës dhe pjesa më e vogël në ndërmarrjet prodhuese.

Ekonomia e Kosovës së pasluftës po shënon rritje të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) krahasuar me periudhën paraprake. Por ajo që ende është brengosëse ka të bëjë me shkallën e të hyrave e cila është ndër më të ulëtat në Evropë. Kosova po ballafaqohet me varfëri të gjerë, por jo edhe shumë të thellë. Gjithashtu, norma e papunësisë që vlerësohet në mbi 50%, vazhdon të jetë ndër më të lartat në regjion. Së këndejmi, reduktimi i këtyre shpërpjesëtimeve duhet të jetë një prioritet afatgjatë. Politika ekonomike për tejkalimin e kësaj gjendje duhet të ketë në fokus rritjen e bizneseve prodhuese dhe rritjen e aftësisë konkurruese përmes rritjes së eksportit. Ecuritë e disa treguesve të rëndësishëm makroekonomik, në periudhën e pasluftës, mund të shihen edhe në tabelën vijuese:

¹⁷ *Sistemi buxhetor i Kosovës - politikat dhe qëndrueshmëria*, Prishtinë, prill 2003.

	2000	2001	2002	2003	2005 ¹⁸	2006	2007
GDP	746,00	1,12	1,28	1,32	3,289	3,528	3,896
GDP për capita	410,00	630,00	680,00	700,00	1,641	1,735	1,885
GNP	1,43	1,88	1,94	1,96	2,969	3,125	3,408
GNP për capita	783,00	1,02	1,04	1,04	1,485	1,537	1,645
Konsumi	2,23	2,50	2,56	2,44	3,419	3,541	3,810
Investimet publike	628,00	588,00	411,00	524,00	629	739	967
Inflacioni %	0,--	11,70	3,60	0,00			
Eksporti	18,88	10,65	27,32	36,20	213	286	343
Importi	635,20	874,40	988,70	968,50	1,292	1,441	1,720
Bilanci	-616,32	-863,75	-961,38	-932,30	-1,079	-1,155	-1,377

Indikatorët kryesorë makroekonomikë (në mil. EURO)¹⁹

Sikurse edhe në vendet e tjera të tranzicionit liberalizimi i tregtisë së jashtme u shoqërua me shpërpjesëtime të mëdha ndërmjet eksportit dhe importit, që shihet edhe nga të dhënat e paraqitura. Megjithatë në Kosovë, për dallim nga vendet e tjera të tranzicionit problemi i fazës fillestare është duke u vonuar.

Bazuar në vlerësimet zyrtare të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe në rezultatet në dispozicion, rritja ekonomike është ngadalësuar si rezultat i zvogëlimit të asistencës së huaj dhe aktivitetit ekonomik ende të ulët (posaçërisht në sektorin e prodhimit). Struktura e importit tregon varësinë e madhe të inputeve dhe të konsumit të ekonomisë së Kosovës, dhe si rezultat i fazës së rindërtimit që gjeneroi rritjen e kërkesës për material ndërtimor në treg e cila ishte në disproporcion me mundësitë e prodhimit vendor. Si pasojë e kësaj Kosova ndeshet me kontribut rënës, në rritjen e PBB-së si të kërkesës së gjeneruar nga donatorët ashtu edhe të eksporteve simbolike të mallrave dhe shërbimeve.

Për arritjen e rezultateve zhvillimore në ekonominë e Kosovës, angazhimi ynë duhet të jetë i përqendruar në krijimin e kushteve për tërheqjen e investimeve të jashtme, angazhimi i

¹⁸ Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Departamenti i Makroekonomisë, *Buletini Gjysmë Vjetor makroekonomik* (vitet 2005, 2006 dhe 2007), Janar-Qershor, Prishtinë, 2008.

¹⁹ MEF, *Monitori Makroekonomik* (vitet 2000,01,02,03), Prishtinë, prill 2004.

të cilave vlerësohet të jetë me prioritet për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Kosovës, sidomos kur kemi parasysh pasuritë e shumta natyrore që disponon vendi ynë dhe mundësitë e vogla investuese të afaristëve vendas. I rëndësishëm për këtë është anëtarësimi i Kosovës në institucionet financiare ndërkombëtare (Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore) dhe rajonale (Banka Evropiane për Rindërtim dhe zhvillim etj.). Kushte të tjera për tërheqjen e investuesve të jashtëm janë: siguria, stabiliteti politik dhe ekonomik, funksionimi i mirëfilltë i ligjeve ekonomike, sistemi i zhvilluar kredito-monetar. Gjithashtu, burim të rëndësishëm të investimeve për ekonominë e Kosovës mund të paraqesë edhe kursimi i bashkatdhetarëve tanë të punësuar përkohësisht në botën e jashtme.

4. Vështrim i përgjithshëm mbi shpërpjesëtimet strukturore

Zhvillimi ekonomik i një vendi definohet sipas shumë faktorëve, kurse çdonjëri prej tyre mund të vështrohet në dimensione të ndryshme cilësore, kuantitative, kohore, dhe të gjitha këto së bashku paraqesin një tërësi për vlerësime dhe analiza ekonomike. Në vlerësimin e shkallës së arritur të zhvillimit ekonomik të një vendi, teoria bashkëkohore e zhvillimit ekonomik në qendër të vëmendjes paraqet ndryshimet strukturore ekonomike. Edhe në planet ndërkombëtare, e posaçërisht në vendet në zhvillim, vëmendje e posaçme u kushtohet ndryshimeve strukturore. Edhe nëse disa argumente janë shumë bindëse, vendet në zhvillim e pranojnë se vetëm industrializimi nuk mund të arrijë një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Andaj nuk është për t'u habitur që edhe organet më kompetente profesionale të Kombeve të Bashkuara, kur kanë të bëjnë me vendet në të cilat do të bëhen ndryshime rrënjësore ekonomike, orvatjet e tyre për zgjidhjen e problemeve i orientojnë pikërisht në ndryshimet strukturore për një periudhë të gjatë kohore. Struktura ekonomike definohet si tërësi e marrëdhënive prodhuese, e cila paraqet bazën reale edhe për ndërtimin e superstrukturës shoqërore. Struktura ekonomike

trajtohet si gjenerator aktual në çdo kohë dhe në çdo shoqëri bashkëkohore. Një rëndësi e tillë strukturës ekonomike i jepet posaçërisht në vendet e zhvilluara.


Teoritë ekonomike bashkëkohore, ndryshimeve strukturore u japin rëndësi primare me rastin e shqyrtimit të problemeve zhvillimore ekonomike, të cilat shërbejnë si kriter për vlerësimin e shkallës së arritur të zhvillimit ekonomik. Në këtë kontekst, analizohet raporti strukturor i të gjithë faktorëve përbërës zhvillimor si: struktura e të ardhurave të realizuara, struktura e të punësuarve, struktura e produktit shoqëror si dhe e të gjithë faktorëve të tjerë relevantë të zhvillimit ekonomik në tërësi. Për përmirësimin e strukturës ekonomike dhe bazës materiale, vendet relativisht të vogla si Kosova duhet të përcaktohen për rritjen e prodhimit për të cilën ekzistojnë parakushtet (resurset e shumta natyrore). Vendet në zhvillim duhet të përshtatin dhe të zgjedhin strukturën e ekonomisë së tyre, e cila mund të gjejë një hapësirë në zhvillimin regional, për të cilin vendet e zhvilluara janë më pak të interesuara. Struktura ekonomike duhet pranuar si raport në mes të pjesëmarrësve në procesin e reproduksionit material, kurse ndryshimi i strukturës ekonomike nënkupton përshtatjen e qëllimit afatshkurtër dhe afatmesëm për arritjen e qëllimeve zhvillimore.

Struktura ekonomike e një vendi, më tepër se cilido tregues tjetër paraqet kahet dhe realitetin zhvillimor, për zhvillimin ekonomik. Kjo ka për qëllim që përmes analizave të ndryshme të konstatohet shkalla e varshmërisë, gjegjësisht ndryshimet në mes të marrëdhënieve në prodhim dhe nivelit të zhvillimit ekonomik, si elementet kryesore dhe të një rëndësie të veçantë për analiza të formave të ndryshme të superstrukturës shoqërore, që paraqet bazën për aktivitete të organizuara ekonomiko-shoqërore dhe nga të cilat varet edhe realizimi me sukses i qëllimeve të parashtruara ekonomike në një shoqëri. Gjatë periudhave zhvillimore, ndryshimet rrënjësore strukturore janë të mundshme, dhe të vërtetuara në raste të shpeshta nga hulumtimet profesionale të ekspertëve të lëmenjve të caktuar ekonomikë. Të gjitha këto kërkojnë ngritje të shkallës së finalizimit, akumulimit, eksportit, zgjidhjeve të reja teknologjike dhe të formave bashkëkohore të organizimit të

punës. Proceset e këtilla bashkëkohore qartësojnë më së miri ndryshimet strukturore në ekonomi përmes degëve dhe lëmenjve ekonomikë. Këtë e tregojnë të dhënat në pasqyrën e mëposhtme:

	1959	1969	1979	1989	1995 ²⁰	2005 ²¹	2006	2007
PRODUKTI SHOQËROR	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0			
Industria dhe xehetaria	36,9	37,1	37,6	52,9	30,6	808	672	530
Bujqësia dhe pylltaria	45,6	33,1	20,5	22,4	30,6	233	191	220
Hidroekonomia	-	-	0,2	0,5	0,7			
Ndërtimtaria	6,2	8,6	11,8	5,8	5,7	500	316	327
Komunikacioni dhe lidhjet	2,7	3,5	5,8	3,8	8,5	1291	858	603
Tregtia	5,3*	1,0*	16,8	7,9	13,8	3867	2630	2363
Hoteleria e turizmi	-	-	2,1	1,5	4,0	964	718	590
Zejtaria	3,3	,7	3,1	2,9	3,3			
Veprimtaritë komunale	-	0,7	0,8	0,8	1,3	901	590	514
Veprimtaritë tjera	-	2,3	1,3	1,6	1,5	526	486	602

Struktura e produktit shoqëror sipas lëmenjve ekonomike, 1959-2007 (në %)




Grafiku nr. 1. Struktura e produktit shoqëror për vitin 1995

²⁰ Mr.sc. Fetah Reçica, vep.cit., f.28.

²¹ Enti i statistikës së Kosovës, *Statistikat e përgjithshme, Buletini mujor*, Prill 2008, Prishtinë. Numri i bizneseve të reja të regjistruara gjatë viteve 2005/ 2006/ 2007 sipas seksioneve të veprimtarive. (Shënim: Tek veprimtaria komunale janë futur administrimi dhe mbrojtja e ambientit, arsimi, shëndetësia dhe aktivitetet e tjera shoqërore dhe sociale, ndërsa tek rendi veprimtaritë e tjera janë të përfshira aktivitetet financiare dhe pasuritë e patundshmërisë, dhënia me qira dhe aktivitetet biznesi).

Struktura e vëllimit fizik të prodhimit industrial (në %)²²

	1975	1980	1988
INDUSTRIA GJITHSEJ	100,0	100,0	100,0
Elektro-ekonomia	19,6	17,5	21,8
Prodhimi dhe përpunimi i thëngjillit	12,0	10,2	13,2
Metalurgjia e zezë	3,2	2,1	2,6
Metalurgjia e ngjyrosur	19,4	15,3	10,6
Jometalet	3,1	1,8	1,8
Industria e përpunimit të metaleve	7,7	8,6	10,1
Elektroindustria	2,4	3,3	9,0
Industria kimike	5,0	7,2	2,0
Industria e materialit ndërtimor	3,3	4,2	2,3
Industria e drurit	2,9	2,9	2,1
Industria e letrës	1,2	1,2	0,6
Industria e tekstilit	10,0	12,6	8,4
Industria e lëkurë-këpucëve	2,2	2,1	2,4
Industria e gomës	1,5	2,6	4,6
Industria ushqimore	4,8	5,0	7,0
Veprimtaria grafike	1,1	2,3	0,7
Industria e duhanit	1,2	1,1	0,8



Struktura e vëllimit fizik të prodhimit industrial

Nga të dhënat e mësipërme shihet se bujqësia deri në vitet e tetëdhjeta gradualisht zvogëlon pjesëmarrjen në krijimin e produktit shoqëror të ekonomisë (nga 45,1% sa ishte në vitin 1959 në 19,8% në vitin 1979). Në të njëjtën periudhë, industria dhe xehetaria shënojnë rritje graduale në strukturën ekonomike të Kosovës (nga 36,9% sa ishte në vitin 1959 në 52,9% në vitin

²² Vjetari Statistikor i KSA të Kosovës 1989.

1989). Një kohë të gjatë bujqësia kishte pjesëmarrjen më të madhe në strukturën ekonomike të Kosovës, dhe ajo ishte e nivelit ekstensiv, me mjete primitive dhe me sipërfaqe tejet të vogla për ekonomitë familjare. Sipërfaqet e vogla të ekonomive familjare nuk premtorin rezultate më të larta.

Pas përfundimit të luftës, me 1999, Kosova si regjion më i pazhvilluar në këtë pjesë të Ballkanit, është përpjekur që ta shpejtojë procesin e zhvillimit ekonomik dhe sa më me sukses të realizojë transformimet ekonomiko-shoqërore.

Struktura e ekonomisë së Kosovës e shikuar nga aspekti i pjesëmarrjes së sektorëve të ndryshëm dhe numri i ndërmarrjeve të regjistruara në krijimin e produktit shoqëror në të ardhurat kombëtare ka përjetuar ndryshime të konsiderueshme. Struktura ekzistuese është pasqyrë e një mos harmonizimi afatgjatë në nivel të ish-Jugosllavisë, dhe në esencë është përcjellë me një zhvillim stihik për një periudhe të gjatë kohore. Një konstatim i tillë mund të shihet nga të dhënat e mëposhtme:

Vepimtaritë ekonomike	Gjithsej	Punë-tor-ve-tëm	Part-neri-tet	Komp-me-akcio	Koo-pera-tivat	Kom-privat	Kom-pub-lik	Pronë-shtet	Pronë-shoqë
Gjithsej	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0
Bujqësi, gjueti dhe pylltari	1,3	1,1	1,6	6,1	12,5	1,6	6,3	14,9	7,6
Peshkim	0,0	-	-	-	-	-	-	1,4	0,4
Industria e minierave dhe industria e ekstrakteve	0,7	0,6	1,0	1,2	50,0	0,6	0,0	2,7	0,8
Industria përpunuese	10,3	10,4	8,4	15,9	6,3	5,5	18,8	9,5	13,7
Furnizimi me energji, gaz, ujë	0,1	-	0,1	-	-	-	3,2	6,8	3,4
Ndërtimtaria	10,5	10,7	8,3	23,2	6,3	9,8	18,8	9,5	5,7
Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave dhe artikujve për përdorim personal dhe shtëpiak	50,7	50,8	53,4	32,9	6,3	61,3	18,8	16,2	21,0
Hotelet dhe restorantet	4,5	4,8	2,0	0,0	0,0	1,0	3,1	2,7	5,3
Komunikacioni	14,8	14,6	18,4	1,2	12,5	17,1	9,4	8,1	14,9
Ndërmjetësimi financiar, afarist	2,4	2,2	2,9	9,8	-	2,0	3,1	4,1	5,8

Arsimi	0,8	0,8	0,4	2,4	6m3	0,0	3,1	8,1	3,1
Mbrojtja shëndetësore dhe sociale dhe veprimtari të tjera shoqërore	1,6	1,4	2,2	-	-	0,4	3,1	4,1	11,1
Shërbime personale	2,5	2,6	1,4	7,3	-	0,6	12,5	12,2	7,3

Ndërmarrjet e regjistruara sipas llojit të pronësisë dhe seksionit të aktivitetit (në %)²³

Në bazë të këtyre të dhënave shihet se pjesëmarrjen më të lartë në regjistrimin e ndërmarrjeve e ka tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe i motoçikletave dhe artikujt për përdorim personal dhe shtëpiak, e cila arrin në 50,7%. Në vendin e dytë për nga pjesëmarrja në strukturën e ndërmarrjeve të regjistruara, sipas kësaj tablele, shihet se është komunikacioni, që mund të konstatohet se një pjesëmarrje të tillë në strukturën e përgjithshme ekonomike nuk e kishte deri tash.

Rëndësi të veçantë për strukturën ekonomike ka ndryshimi i marrëdhënieve në prodhim ose i marrëdhënieve pronësore të mjeteve të prodhimit. Ato praktikisht ngacmojnë ndryshimet cilësore në sistemin ekonomik. Me gjithë faktin se në ekonominë e Kosovës ekziston një strukturë ekonomike e papërshtatshme, ku mbizotëron pjesëmarrja e lartë e degëve energjetike dhe e lëndëve të para, të cilat nuk mund të paraqesin një faktor potencial për zhvillimin e ardhshëm, por mund të krijojnë kushte për zhvillimin e industrisë përpunuese. Gjatë dy viteve të fundit i është kushtuar vëmendje e madhe politike çështjes së punësimit të të rinjve në Kosovë, meqë sfidat dhe vështirësitë e tyre për të hyrë në treg të punës shtohen edhe më shumë nga numri i të rinjve që punojnë në punë të rrezikshme, shpesh në ekonominë joformale.²⁴

Në strukturën e investimeve ekonomike në Kosovë, pjesëmarrje më të lartë paraqesin degët kapitale investuese me afat më të gjatë të aktivizimit të tyre dhe të tejkalimeve të mëdha të investimeve, si dhe me koeficient mjaft të papërshtatshëm të kapitalit. Njëherësh, efekte të ngjashme kanë dhënë edhe

²³ Enti i statistikave të Kosovës, "Pasqyrë statistikore mbi bizneset e regjistruara në Kosovë", Prishtinë, 2002.

²⁴ Plani aksional i punësimit të të rinjve në Kosovë - kornizë e politikave afatmesme (2007-2010), tetor, 2006.

investimet për ndërtimin e infrastrukturës përcjellëse ekonomike, si dhe të elementeve të tjera të ekonomisë eksterne. Investimet e tilla kanë lënë hapësirë të vogël për zhvillimin e sektorit të përpunimit, me të cilin arrihet një qarkullim më i shpejtë dhe një dinamikë më e madhe e shtimit të ardhurave kombëtare dhe e punësimit, si një nga problemet më të theksuara në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Rezervat e mëdha të linjtit, si dhe kushtet shumë të përshtatshme të eksploatimit kanë mundësuar zhvillimin intensiv të energjetikës, e sidomos me ndërtimin e kapaciteteve të mëdha të energjetikës dhe të industrisë bazike. Lidhur me këtë duhet të thuhet se Kosova në fund të viteve të tetëdhjeta krijoi pjesëmarrje të lartë në nivel të ish-Jugosllavisë dhe atë në kompleksin e energjetikës 7,0%, prodhimin e thëngjillit 14,1%, ferolegurat 9,0%, prodhimin e metalit plumb-zink 32,0%, plumbi i rafinuar 76,0%, legurat e plumbit 52,0% dhe argjendi i rafinuar 67,0%, ndërsa pjesëmarrja në produktin shoqëror të ish-Jugosllavisë ishte afro 2,0%. Kjo pjesëmarrje kaq e lartë e këtyre komplekseve e ka ashpërsuar raportin brenda ekonomisë së Kosovës. Kështu që energjetika, metalet me ngjyrë dhe metalurgjia e zezë, së bashku, kishin pjesëmarrje në produktin shoqëror të industrisë me 45,0%, në punësim 35,0% dhe në fondet fikse 60,0%. Në pajtim me këtë, si burim i zhvillimit ekonomik është vlerësuar faktori material ekstensiv e më pak ata jomaterialë. Reduktimi i rëndësisë së faktorëve jomaterialë (shkenca dhe teknologjia e avancuar, ndërmarrësi dhe menaxhmenti bashkëkohor, forcimi i komponentit shkencor në zhvillim) kanë bërë që në zhvillimin e deritanishëm të mos aktivizohen potencialet e popullsisë së aftë për punë. Si pasojë e mekanizmave sistemorë dhe zhvillimorë, vendi ynë në një periudhë të gjatë kohore faktikisht ngeli dhe vendnumëroi. Për këtë arsye paraqitet nevoja e përhershme e studimit analitik të ndryshimeve strukturore ekonomike dhe mundësive eventuale për ndryshimet pozitive në elementet e saj përbërëse strukturore dhe e raporteve të cilat duhet të paraqiten si rezultat i krahasimit të disa treguesve me ndikim të veçantë në rritjen dhe ndryshimet e strukturës ekonomike. Gradualisht, zhvillimi i industrisë avancohej krahas rritjes së pjesëmarrjes në strukturën e përgjithshme ekonomike dhe rënies së pjesëmarrjes së bujqësisë. Aspekt të veçantë të strukturës të industrisë së

Kosovës paraqesin shpërpjesëtimet brenda vetë komplekseve industriale, si pasojë e nivelit të ulët të përpunimit dhe finalizimit të produkteve të gatshme, dhe mos aktivizimit të përparësive krahasuese në zhvillim. Është me rëndësi të theksohet se degët industriale të cilat disponojnë kapital me pjesëmarrje të lartë dhe të cilat krijojnë të ardhura të larta, zakonisht punësojnë numër të vogël të punëtorëve mu për shkak të automatizimit të procesit të punës. Këtë avantazh mund ta krijojë energjetika e cila ngushton hapësirën për ndryshime strukturore në favor të sektorëve të industrisë përpunuese, të cilat do të kishin efekte më të mëdha në punësim.

Edhe në kuadër të degëve të tjera të Kosovës së para okupimit, ka gjetur shprehjen krijimi i shpërpjesëtimeve strukturore, ku pjesëmarrja e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike në produktin shoqëror të energjetikës arrin në 53,0%, përpunimi i thëngjillit 1,0%, përpunimi i metaleve me ngjyrë në metalurgji 3,6%, prodhimi i produkteve finale të tekstit në degën e industrisë së tekstit dhe lëkurë-këpucëve 32,8%, industria e prodhimit të produkteve ushqimore për konsum në agrokomples 52,4%, prodhimi i pijeve në produktin shoqëror të agrokomplesit 36,5%).

Gjatë kësaj periudhe, eksporti i Kosovës ishte i pamjaftueshëm, si nga aspekti cilësor, ashtu edhe nga aspekti sasior dhe strukturor. Gjithashtu, bartës kryesor i degëve eksportuese në Kosovë ishte industria. Në kuadër të degëve eksportuese të industrisë, më të rëndësishmet ishin: energjetika, metalurgjia e ngjyrosur, metalurgjia e zezë, si dhe prodhimi i makinave dhe i aparateve elektrike, veprimtaria metal-përpunuese, prodhimi i mjeteve të komunikacionit, prodhimi dhe përpunimi i produkteve kimike, prodhimi i tjerit, prodhimi i kauçikut e të tjera. Vështruar sipas produkteve, pjesëmarrje më të lartë në eksport kishte industria e akumulatorëve, prodhimi i pjesëve të automobilave, të cilat tani kryesisht kanë karakter simbolik në strukturën e industrisë dhe të ekonomisë së Kosovës në tërësi. Ndryshimet zhvillimore në Jugosllavi ishin mjaft të theksuara. Deri sa në pjesën veriore dhe perëndimore të vendit ishin të theksuara proceset e zhvillimit të industrializimit, pjesën jugore (Kosovë) e përbënin të gjitha karakteristikat e një ekonomie të prapambetur me një strukturë

të theksuar të kompleksit agrar. Dallimet e tilla vetëm se janë thelluar e jo përmirësuar.

Nëse ndryshimet strukturale analizohen nga aspekti i bizneseve sipas numrit të punëtorëve, del se industria, komunikacioni dhe tregtia gjithnjë e më tepër po bëhen degë me rëndësi të veçantë për ekonominë e Kosovës, si në krijimin e produktit shoqëror, ashtu edhe në të ardhurat kombëtare, që ndikon edhe në shtimin relativ të numrit të të punësuarve, tek të cilët për çdo ditë e më tepër po bëhen ndryshime pozitive në përgatitjen profesionale, me qëllim të përshtatjes sa më të mirë të kuadrove në proceset e reja teknologjike. Një konstatim i këtillë mund të shihet edhe në bazë të këtyre të dhënave:

	Gjithsej	Bizneset sipas numrit të punëtorëve						
		1-4	5-9	10-19	20-49	50-99	100-499	mbi 500
Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria	370	253	45	25	18	17	9	3
Peshkimi	5	3	1	0	0	0	0	0
Industria e minierave dhe ekstrakteve	190	145	18	13	4	5	2	3
Industria përpunuese	2.927	2.066	339	202	129	81	67	43
Furnizimi me energji elek. gaz, ujë	19	1	7	5	3	0	2	1
Ndërtimtaria	3.001	1.689	667	325	196	87	28	9
Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave dhe i artikujve për përdorim personal dhe shtëpiak	14.476	12.511	768	559	342	199	69	28
Hotelet dhe restorantet	1.279	1.082	87	53	24	12	16	5
Komunikacioni ⁵²⁾	4.231	3.629	356	121	85	13	18	9
Ndërmjetësimi financiar	662	534	44	42	16	8	9	7
Arsimi	223	174	13	19	6	3	4	4
Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	446	379	26	18	13	2	5	3
Shërbimet personale	726	601	51	47	18	5	3	1

Ndërmarrjet e regjistruara sipas numrit të punësuarve dhe seksionit të aktiviteteve²⁵

²⁵ Enti i Statistikave të Kosovës, *Pasqyrë statistikore mbi bizneset e regjistruara në Kosovë, Prishtinë, 2002.*

Gjithashtu, edhe këtu ndërmarrjet më së tepërmi kanë të punësuar 1-4 punëtorë, me gjithsej 3.629 ndërmarrje të komunikacionit. Numri më i madh (43) i ndërmarrjeve me mbi 500 të punësuar paraqitet në industrinë përpunuese.

Edhe në bazë të kësaj shihet se industria për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik ka një rol jashtëzakonisht të madh, e cila mund të shprehet edhe në shkallen e shtimit ekonomik, në ndryshimet strukturore ekonomike dhe sociale të popullsisë.

Për zhvillimin e degëve të industrisë, në periudhën e deritashme kanë ndikuar edhe resurset natyrore të cilat kanë ndikuar për orientimin e investimeve.

Siç shihet në strukturën e vëllimit fizik të prodhimit industrial, pjesëmarrje më të madhe ka elektroekonomia, prodhimi dhe përpunimi i thëngjillit, kurse pjesëmarrja e metalurgjisë së ngjyrosur është në zvogëlim gradual. Kritje të përhershme kanë regjistruar edhe industria e përpunimit të metaleve, elektroindustria, industria e gomës dhe industria ushqimore.

Gjendjes së këtillë të pavolitshme i kanë kontribuar problemet të cilat edhe tani e përcjellin: shkalla e ulët e produktivitetit të punës, aftësia e dobët akumuluese dhe reproduktuese, ndihma e pamjaftueshme nga jashtë, sigurimi dhe zgjedhja e teknologjisë bashkëkohore, ndarja ndërkombëtare e punës, shfrytëzimi i pamjaftueshëm i kapaciteteve, efikasiteti i dobët i investimeve, shfrytëzimi jo adekuat i kushteve natyrore për shtimin e prodhimit bujqësor, tejkalimet e shpeshta në ndërtimin e infrastrukturës dhe dendësia e popullsisë. Të gjitha këto pengonin një zhvillim më dinamik në ekonominë e Kosovës.

5. Përfundim

Bota bashkëkohore ecën përpara - ajo është e përmbushur me projekte, ide dhe synime të ndryshme të mbështetura në një shpresë pothuajse unike e cila drejtohet me kërkesën për zgjerimin dhe forcimin e mirëqenies njerëzore - së paku kështu mendohet në opinion. Në vllugun e zhvillimeve ndeshemi, normalisht, në probleme, kundërthënie, por edhe në ujdi dhe në mirëkuptime. Në të shumtën e rasteve këto i shkaktojnë ndërrimet e shpeshta të

sistemeve, nënsistemeve dhe organizimet e ndryshme në ndërmarrje të cilat me kalimin e kohës tregohen të pasuksesshme dhe kërkohet që të njëjtat të ndërrohen apo së paku të korrigjohen. Ekzistenca e njerëzimit dhe zhvillimi në të gjitha sferat e jetës nuk mund të mendohet pa një organizim të përgatitur dhe të zbrërthyer në mënyrë profesionale.

Me rëndësi esenciale për një zhvillim të mirëfilltë është përgatitja e projekteve me të cilat mund të realizohen synimet e caktuara zhvillimore përmes aplikimit të teknologjive bashkëkohore. Sa i përket përgatitjes së projekteve duhet të merret për bazë së pari koncepti i përcaktuar me përshkrimin e nevojave dhe mundësive të zhvillimit më të shpejtë të degëve që sigurojnë profit më të madh. Edhe gjendja e tashme në ekonominë e Kosovës tregon për faktin se kësaj çështje nuk i është kushtuar kujdes i merituar dhe së paku mund të thuhet se edhe tani ekziston një disproporcion zhvillimor, ngase projektet dhe përkrahja për zhvillim në raste të shpeshta ka qenë e përgatitur dhe e realizuar në segmentet e lëmenjve dhe degëve të tjera, ndërsa degët profitabile me gjithë rolin e tyre për një zhvillim të suksesshëm, janë lënë anash. Kësaj në masë të madhe i ka kontribuar edhe mungesa e shtëpive projektuese në Kosovë, kështu që projektet zhvillimore në nivel të Kosovës zakonisht i kanë bërë institutet e ndryshme nga vendet e ish-Jugosllavisë, me të cilat vetëm pjesërisht është arritur suksesi i pritur, kurse problemet kryesisht janë zgjidhur nga rasti në rast.

Pa dyshim se disa çështje të shtruar në këtë analizë kërkojnë përpunim të mëtejshëm analitik apo edhe studim të hollësishëm për çdo çështje në veçanti me qëllim të zgjidhjes më të lehtë të problemeve zhvillimore në tërësi, zgjedhja e të cilave do të varet kryesisht nga prosperiteti ekonomik i vendit me rrethinë, dhe nga angazhimi maksimal i të gjitha subjekteve, shfrytëzimi intensiv i institucioneve profesionale si dhe afirmimi më i madh në këtë lëmi me theks të veçantë në tregun e shërbimeve profesionale vendore dhe ndërkombëtare

Gjithashtu duhet të theksohet se dinamika e zhvillimit në këtë periudhë nuk ishte në përputhje me parashikimet dhe mundësitë ekzistuese. Nuk u realizuan parashikimet as në aspektin e zvogëlimit të dallimeve në ritmin e zhvillimit, krahasuar me vendet tjera të sh-Jugosllavisë.

Bibliografi

- Abdyli, Dr.Tahir. *Zhvillimi i industrisë në Kosovë: "Enti i Historisë së Kosovës"*, Prishtinë: 1978.
- Berisha, Dr. Skënder. "Ekonomia e Kosovës - dje, sot dhe nesër", *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filologjik, Prishtinë: 2003.
- Enti i Statistikave të Kosovës. *Pasqyrë statistikore mbi bizneset e regjistruara në Kosovë*, Prishtinë: 2002.
- Enti i Statistikës së Kosovës. *Statistikat e përgjithshme, Buletini mujor*, Prishtinë, 2008.
- Kuvendi i KSA të Kosovës, Enti Krahinor për Planifikimin Shoqëror, *Ecuritë aktuale ekonomike në Kosovë*, Prishtinë: 1989.
- Instituti Ekonomik, *Koncepti i zhvillimit afatgjatë të KSA të Kosovës deri në vitin 2000*, Prishtinë: 1985.
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Departamenti i Makroekonomisë, *Buletini Gjysmë vjetor makroekonomik*, Prishtinë: Janar-Qershor 2008.
- Oda ekonomike e Kosovës, *Ecuritë ekonomike*, Prishtinë: 1987.
- Plani aksional i punësimit të rinjve në Kosovë - kornizë e politikave afatmesme (2007-2010)*, Prishtinë: 2006.
- Raporti vjetor i aktivitetit të donatorëve në Kosovë*, Prishtinë: (shtator) 2003.
- Reçica, Mr.sc. Fetah, *Komunikacioni, faktor i zhvillimit ekonomik të Kosovës*, tezë e doktoratës, Prishtinë, 2004 f. 38 (dorëshkrim).
- Sirotković, Jakov, *Teorija i politika ekonomskog razvoja*, "Informator", Zagreb: 1976.
- Sistemi buxhetor i Kosovës-politikat dhe qëndrueshmëria 9*, Prishtinë: 2003.
- Vjetari Statistikor i RSFJ*, Prishtinë: 1990.
- Vjetari Statistikor i KSA të Kosovës*, Prishtinë: 1989.
- Zhvillimi ekonomik lokal, investimet e jashtme direkte në Kosove, "Riinvest", Prishtinë: 2004.